Përmbajtja

Fjala Hyrëse....4
Kush jemi ne?....8
Synimet dhe objektivat tona....9
Akterët relevant....10
Konteksti ynë....11
Si planifikojmë ne?....12
Raporti Vjetor për 2016-n....14
Aktivitetet e realizuara....14
Standardet e Profesionit....14
Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve....16
Validimi i kualifikimeve në KKK dhe Akreditimi i ofruesve të AAP-së....22
Vizita në teren....23
Përpilimi i raportit final të vlerësimit për Validim dhe Akreditim....24
Promovimi i KKK-së dhe AKK-së....27
Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes....32
Bashkëpunimi ndërkombëtar....33



Fjalë hyrëse

Gjatë vitit 2016, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ka vazhduar drejt realizimit të misionit të saj: për të ndihmuar gjithë ofruesit e trajnimit dhe nxënësit, për të lëvizur drejt niveleve të përsosmërisë në arsim dhe trajnim, për të rritur cilësinë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional, për t'iu mundësuar nxënësve që të pajisen me shkathtësitë e duhura për tregun e punës dhe më e rëndësishmja, për të bërë të mësuarit gjatë gjithë jetës një mjet për të mbështetur punësimin e tyre.

Ky raport është dëshmi e udhëheqjes kreative, angazhimit serioz dhe punës së vështirë. Bazuar në punën cilësore dheaktivitetet e shumta kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara, është e qartë se AKK është duke ndërtuar një reputacion të standardit të lartë, konsistencës dhe të shërbimit në komunitetin tonë. Lista e ngjarjeve të organizuara gjatë 2016 është mbresëlënëse, sidomos kur merren parasysh burimet e kufizuara njerëzore që AKK posedon. Efekti sinergjik brenda këtij ekipi të vogël, por entuziast, ka dhënë rezultate të rëndësishme, të cilat janë të evidentuara nga reputacioni dhe kredibiliteti i AKK-së brenda dhe jashtë vendit.

Edhe gjatë vitit 2016, AKK-ja ka vazhduar me verifikimin e standardeve të profesionit, miratimin e kualifikimeve në nivelet 2,3, 4 dhe 5 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), si dhe akreditimin e institucioneve që vlerësojnë dhe lëshojnë këto kualifikime. Më tej, AAK gjatë këtij viti, kanë vazhduar aktivitetet dhe angazhimi për përgatitjen e infrastrukturës së ofruesevepër validimin e të mësuarit informal dhe joformal, për të mbështetur të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për t'u dhënë vlerë të gjitha formave të të mësuarit, në mënyrë që të lehtësojë mobilitetin e kandidatëve dhe fuqisë punëtore.

AKK-ja ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve përmes seminareve në të gjitha shkollat e të arsimit profesional dhe ofruesit e akreditуar për zbatimin e Kornizës Kombëtare për Sigurim të Cilësisë- një mekanizëm që ndihmon shkollat profesionale dhe gjithë ofruesit e trajnimit që të përmirësojnë cilësinë në AAP.

Një ndër sukseset e arritura të AKK-së për vitin 2016 është referencimi apo lidhja zyrtare e KKK me KEK e cila është arritur si rezultat i një procesi 4 vjeçar të përpilimit të raportit të referencimit nën udhëheqjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Raporti është hartuar në përputhje me metodologjinë dhe kriteret rigoroze të KEK-se dhe është rezultat i një procesi të gjatë konsultativ me të gjitha palët e interesit përfshirë edhe ekspertët ndërkombëtar meqë rast pasqyron në mënyrë transparente dhe reale sistemin tonë të arsimit dhe trajnimit në të gjitha nivelet duke përfshirë të arriturat, sfidat dhe veprimet e planifikuara për ti tejkaluar këto sfida duke mundësuar në këtë mënyrë krahasimin në mes KKK-së me KEK.

AKK-ja ka qenë mjaft aktive në ngjarjet tjera rajonale dhe evropiane në fushën e kualifikimeve dhe të sigurimit të cilësisë. AKK-ja edhe gjatë vitit 2016, ka marr pjesë në të gjithat takimet e Rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP – EQAVET, si anëtare

Për këto arritje, ne i jemi shumë mirënjohës Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Fondacionit Evropian për Trajnim dhe Këshillit Britanik për angazhimin dhe zotimin e vazhdueshëm për të përkrahë AKK-në drejt përmbushjes së misionit të saj që të rrisë cilësinë në arsimin dhe aftësimin në Kosovë, gjithnjë duke u fokusuar në filozofinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Unë do të doja të zgjeroj këtë falënderim për të gjithë partnerët dhe donatorët e tjerë që mbështesin punën e AKK-së!
Një falënderim i veçantë vlen edhe për ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, për mbështetjen e iniciativave tona dhe zotimin për përkrahje të mëtejme të AKK-së dhe KKK-së. GjithashtuKëshillin Drejtues dhe stafin ekzekutiv të AKK-së për kontributin madhor në zhvillimin e institucionit, si dhe performancën gjatë vitit 2015-16!
Njëfalënderim i veçantapër ish drejtoreshën e AKK znj. Teuta Danuza pasnjë performance te shkëlqyer dhe te gjithë kontributin e dhënëqë nga themelimi i AKK



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Këshilli Drejtues:

Osman Buleshkaj [1]	Kryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (MASHT)
Anton Gojani	Nënkryetar i Këshillit Drejtues të AKK-së (DonBosko)
Agim Shahini	Anëtar -Aleanca Kosovare e Biznesit
Fetije Huruglica	Anëtare- Ministria e Shëndetësisë
Ilir Salihu [2]	Anëtar -Ministria e Tregtisë dhe Industrisë * *deri me datë 1 Qershor 2016*
Bedri Xhafa	Anëtar – Agjencia e Përkrahjes së Punësimit në Kosovë
Besim Mustafa	Anëtar- Oda Ekonomike
Jehona Namani	Anëtare -Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Furtuna Mehmeti	Anëtare - Agjencia e Akreditimit të Kosovës
Visar Jasiqi [3]	Anëtar- Universiteti Amerikan i Kosovës * *deri me datë 1 Nëntor 2016*
Mehreme Llumnica	Anëtare -Handikos
Ardita Dushi	Anëtare -Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Teuta Danuza	Anëtare -Universiteti i Prishtinës

[1] Nga data 31 Gusht: Arjeta Emra - Anëtare-Këshilli Britanik (MASHT)
[2] Nga data 1 Qershor 2016 - Lulzim Krasniqi
[3] Nga data 16 Nëntor 2016 - Peonare Caka-Universiteti Amerikan i Kosovës

Stafi ekzekutiv:

Teuta Danuza[4]	Drejtoreshë
Avni Gashi	Ekspert për sigurim të cilësisë
Bleta Kadriu	Eksperte për standarde
Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime
Kaltrina Mulliqi	Eksperte për sigurim të cilësisë
Anita Rukovci	Zyrtare e lartë për monitorim pas akreditimit të institucioneve
Donjeta Nimani	Asistente Administrative

[4] Nga data 18.11.2016 Avni Gashi me vendim te Ministrit emërohet u.d. i drejtorit të AKK



Kush jemi ne

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) është organ i pavarur publik, i themeluar në dhjetor të vitit 2009, bazuar në Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Ligji 03/L-060).

AKK-ja ka përgjegjësi të përgjithshme për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK); në përcaktimin e niveleve të kualifikimeve në KKK, harmonizimin e niveleve të kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK), caktimin e kritereve për aprovimin e kualifikimeve dhe akreditimin e institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional(AAP), përfshirjen e kualifikimeve të aprovuara në KKK, lehtësimin e progresit dhe transferit ndërmjet formave të ndryshme të të mësuarit, dhe sigurimin e cilësisë në institucionet e akredituara të AAP-së.
AKK-ja ka Këshillin Drejtues prej trembëdhjetë (13) anëtarësh, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, i cili është i përfaqësuar nga ministritë, organizatat e partnerëve social dhe universitetet publike.

AKK-ja ka stafin ekzekutiv prej gjashtë (6) anëtarëve: të drejtores, zyrtares për standarde, zyrtarit për kualifikime, dy zyrtarëve për sigurim të cilësisë dhe asistentes administrative.


Synimet dhe objektivat tona

Misioni i AKK-së është të mbikëqyrë dhe zhvillojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve në kontekst të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në partneritet me nxënësin/kandidatin, punëdhënësin dhe ofruesit e arsimit dhe aftësimit në të gjitha nivelet dhe në përputhshmëri me nevojat dhe kërkesat e shoqërisë dhe ekonomisë.

Vizioni i AKK-së është krijimi i një sistemi cilësor, të besueshëm dhe transparent të kualifikimeve kombëtare, me qëllim të rritjes së mundësive për mobilitet kombëtar dhe ndërkombëtar.

Për të arritur këtë,AKK-ja do të:

- aprovojë kualifikime që do të përfshihen në nivelet e caktuara të kornizës dhe t'i riaprovojë ato sipas nevojës;
- akreditojë, rregullojë dhe monitorojë ofruesit e arsimit dhe aftësimit profesional;
- zbatojë sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çojnë deri te dhënia e kualifikimeve në KKK;
- mirëmbajë bazën e të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna;
- bëjë rishikime periodike të vlerësimit, si dhe krahasime ndërkombëtare të kualifikimeve;
- këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe barasvlerës;
- Certifikatat dhe diplomat e dhëna për të gjitha kualifikimet në kornizë miratohen me vulë të autoritetit dhe përfshijnë titullin e aprovuar të kualifikimit, nivelin e tij në KKK dhe informata të tilla varësisht nga kërkesa eAKK-së.



Ligji për Kualifikime Kombëtare



Akterët Relevantë

Për të ushtruar funksionet dhe përgjegjësitë e veta, AKK-ja krijon dhe mirëmban raporte bashkëpunuese dhe procese konsultative me të gjithë akterët relevantë të KKK-së, përfshirë:

- Nxënësin/kandidatin
- Mësimdhënësit dhe trajnerët
- Menaxherët në shkolla, kolegje universitare dhe universitete
- Koordinatorët për sigurimin e cilësisë tek ofruesit
- Punëdhënësit dhe punëtorët
- Ofruesit publik dhe privat të aftësimit profesional
- Sindikata dhe shoqata profesionale
- Qeverinë në nivel qendror dhe lokal
- Agjenci dhe Këshille në nivel kombëtar

Konteksti ynë

Sistemi i Arsimit dhe Aftësimit Profesional (AAP), si dhe ai i Arsimit të Lartë(AL) në Kosovë, duhet t'i plotësojë në mënyrë adekuate nevojat e ekonomisë së tregut. Ngritja e cilësisë së sistemit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional dhe Arsimit të Lartë, është prioritet i Qeverisë së Kosovës, në mënyrë që shkathtësitë profesionale dhe kompetencat e individëve që përfundojnë AAP-në dhe AL-në të jenë në nivel të kënaqshëm. Për momentin, ende mbetet sfidë për Kosovën të krijojë një fuqi punëtore të aftë, fleksibile që të mund të konkurrojë në tregun vendor, rajonal dhe global. Prandaj, një ndër kriteret kryesore që duhet të plotësojnë kualifikimet për t'u aprovuar dhe vendosur në KKK është përputhja e këtyre kualifikimeve me kërkesat e tregut të punës. Në këtë mënyrë, ky është ndikimi i drejtpërdrejtë i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në ekonominë kosovare. Kjo kornizë me kriteret e saj parasheh që fillimisht institucionet, të cilat dëshirojnë të zhvillojnë një kualifikim, duhet të paraqesin dëshmi se kualifikimi është i kërkuar në tregun e punës. Si dëshmi mund të përdoren hulumtimet e tregut të punës, konsultimet, rekomandimet e institucioneve qeveritare që zhvillojnë politika zhvillimore si MASHT-i, KAAP-i, OEK-u, MPMS-i, etj. Gjithashtu, sipas KKK-së kualifikimet e zhvilluara duhet të bazohen në standarde profesionale, të cilat janë bazë për ta arritur këtë (kualifikimin). Këto standarde profesionale duhet të zhvillohen drejtpërdrejt bazuar në kërkesat e profesionit të caktuar në vendin e punës. Pra, punëdhënësi merr pjesë aktive në këtë proces dhe paraqet kërkesat e nevojshme, të cilat punëtori duhet t'i demonstrojë për kualifikimin në fjalë. Kjo është një ndër kriteret e KKK-së që duhet të plotësohet nga institucionet, të cilat zhvillojnë kualifikime.

AKK-ja ka zhvilluar dhe hartuar udhëzues të shumtë, të cilët do t'i ndihmojnë që institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional të përmbushin këto kritere dhe të jenë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve.



Këshilli Drejtues i AKK



Këshilli Drejtues i AKK

Si planifikojmë ne?

AKK-ja zhvillon politikat dhe strategjitë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve në pajtueshmëri me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare (Nr.03/L-060).

Bazuar në objektivat strategjike të AKK-së, ne zhvillojmë Planin e Punës së AKK-së duke përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet për 12 muajt e ardhshëm. Stafi ekzekutiv i AKK-së është përgjegjës për zbatimin e zotimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e Punës, ndërsa në çdo takim të KD-së të AKK-së rishikohet progresi i aktiviteteve sipas Planit të Punës.

AKK-ja paraqet raportin mbi progresin e aktiviteteve të veta te MASHT-i, Zyra e Kryeministrit dhe ministritë relevante të AKK-së, çdo gjashtë muaj, ndërsa raportin vjetor e parashtron në Qeverinë e Kosovës.

Plani i Punës për vitin 2016

KD i AKK-së në fillim të vitit miratoi Planin e Punës për vitin 2016. Synimet kryesore të AKK-së për vitin 2016 janë si më poshtë:

1. Popullimi e KKK-së me aprovimin e kualifikimeve pas procesit të validimit;
2. Akreditimi i ofrueseve publik dhe privat të arsimit dhe aftësimit profesional në të gjithë vendin;
3. Kontributi në sigurimin e cilësisë së programeve dhe aktiviteteve në shkollat profesionale të MASHT-it;
4. Strategjia ndërvepruese e komunikimit, që siguron efikasitet më të madh në procesin e validimit, akreditimit dhe sigurimit të cilësisë;
5. Konsultimi i gjerë me akterët relevantë të KKK-së;
6. Promovimi i KKK-së me organizimin e aktiviteteve që krijon vetëdijesim të audiencës së përgjithshme dhe të synuar për fushëveprimin e AKK-së;
7. Pjesëmarrje të gjerë në projektet e BE-së dhe aktiviteteve ndërkombëtare, si pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të AKK-së.

Plani i Punës për vitin 2016 i detajizuar mund të shkarkohet nga ueb-faqja e AKK-së www.akk-ks.net



Pamje nga Punetorite e AAP-së

RAPORTI VJETOR PËR 2016-tën

Ky raport është një përmbledhje e të gjitha aktiviteteve dhe objektivave të realizuara të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) gjatë vitit 2016 në përputhje me Planin e veprimit për këtë vit në përputhje dhe në harmoni me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, si dhe sipas Planit vjetor të aktiviteteve, të hartuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së. Në këtë raport do të paraqiten, të ndarë në sektorë, të gjitha aktivitetet e realizuara për zhvillimin dhe implementimin e KKK-së, gjatë këtij viti.

AKTIVITETET E REALIZUARA

Standardet e profesionit

AKK gjatë këtij viti ka realizuar rreth 17 procese të verifikimit të standardeve të profesionit që ka rezultuar me ngritjen e standardeve të aprovuara në nivel shteti në 60 sosh. Për këto procese janë realizuar procedura të rektrutimit të stafit sipas legjislacionit në fuqi.

Standardet e profesionit janë zhvilluar nga Projekti ALLED-it, shkollat profesionale, Oda Ekonomike e Kosovës dhe shoqata të ndryshme. Standardet, të cilat janë përcjellë nga KAAP-ja për verifikim dhe validim në AKK, ku si rrjedhojë janë verifikuar këto standarde:

- Kontrolluesi/kontrolluesja teknik/e e automjeteve;
- Ekzaminer/ekzaminere e mjeteve motorike;
- Bashkëpunëtorë profesional të punës sociale;
- Menaxher i mirëqenies sociale;
- Profesionist i punës sociale dhe i këshillimit;
- Prodhuesit e kulturave të përziera dhe të kafshëve;
- Punëtorët profesional për përpunimin e ushqimit dhe profesionet e përafërta;
- Operator i veglave të makinave;
- Operatorë të robotëve industrial-teknik i drejtimit të proceseve;
- Autongjyrosës;
- Dizajni i enterierit dhe teknologjia e drurit;
- Grimer/Grimere;
- Manikyrist/ Manikyrise;
- Nëpunës/Nëpunëse kontabiliteti;
- Edukim profesional për kozmeticente;
- Transport rrugor;
- Trafik Rrugor.

Pamje nga ambientet e AAP-së



Pamje nga Punetorite për Ilojet dhe tipet e kualifikimeve në KKK

Rregullimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve

KKK-ja është e rregulluar përmes mekanizmave që synojnë të sigurojnë përputhje me aranzhimet dhe kërkesat e përcaktuara për sistemin e kualifikimeve, dhe për të siguruar se sistemi ofron kualifikime me cilësi të pranueshme. Tashmë janë rregulluar të gjithë mekanizmat për arritjen e këtyre objektivave:

- Validimi dhe aprovimi i kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK;
- Akreditimi i institucioneve përgjegjëse për vlerësimin dhe certifikimin e kualifikimeve të miratuara të KKK-së;
- Sigurimi i cilësisë së institucioneve të akredituara dhe ofrimi i kualifikimeve të validuara;
- Sistemi i kredive;
- Njohja e mësimit paraprak.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar sa më mirë rregullimin e KKK-së ka mbajtur mbi 50 takime në zyrat e veta që kryesisht kishin të bëjnë me:

- Rishikimin dhe adaptimin e planit të punës;
- Përgatitjen për procesin e validimit dhe akreditimit;
- Përgatitjen e certifikatave dhe vendimeve për akreditim;
- Hartimin e konkurseve për panele të ekspertëve të jashtëm dhe botimit të tyre në gazetat ditore;
- Përgatitjen e listës së ngushtë, intervistimin dhe përzgjedhjen e ekspertëve të jashtëm;
- Përgatitjen e planeve për aktivitetet e SC-së të mbështetura nga Këshilli Britanik;
- Organizimin e konferencave për shtyp;
- Planifikimin dhe organizimin e punëtorive për sigurim të cilësisë;
- Mbështetjen për takimet e Këshillit Drejtues të AAK-së;
- Mbajtjen e takimeve të rregullta me zyrtarët e MASHT-it;
- Organizimin e vizitave në teren, dhe për panelet e ekspertëve të jashtëm për validim dhe akreditimin;
- Etj.



Pamje nga punëtoria për hartimin e Raportit të Referencimit

Një ndër sukseset e arritura të AKK-së për vitin 2016 është referencimi apo lidhja zyrtare e KKK-së me KEK-un është arritur si rezultat i një procesi 4 vjeçar të përpilimit të raportit të referencimit nën udhëheqjen e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Pas pranimit të AKK-së në grupin këshilldhënës në fund të vitit 2015 AKK në takimn e parë ka kërkuar që gjatë vitit 2016 të fillojë procesin e referencimit apo lidhjes zyrtare të KKK-së me KEK-un. Ky proces përbëhet nga dy pjesë dhe nëse pjesa e parë nuk kalohet me sukses nuk mund të kalohet në pjesën përfundimtare të këtij procesi. Në shkurt të viti 2016 AKK-ja ka bërë prezantimin e parë të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve para grupit të shteteve që janë pjesë e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. Ky prezantim ka qenë i suksesshëm dhe i ka mundësuar AKK që në fund të vitit të prezantojë raportin e Referencimit të KKK-së me KEK-un për të vendosur lidhjen zyrtare të KKK-un me KEK-ja. Për përditësimin e raportit të vitit 2014 AKK ka themeluar një grup bërthamë që ka rishkruar draft raportin i cili raport pastaj është prezentuar në një punëtori në Durrës me të gjitha palët e interesit. Punëtoria është mbështetur nga projekti ALLED. Pas punëtorisë janë marrë parasysh të gjitha inputet edhe komentet nga palët e interesit në draftin final të raportit.



Pamje nga Konferenca e prezantimit
të e Raportit të Referencimit

AKK-ja gjatë hartimit të draft raportit, në vazhdimësi është konsultuar edhe me ekspertë ndërkombëtar rreth rekomandimeve, të cilat janë inkorporuar në këtë raport dhe që kanë pasur ndikim në cilësinë e raportit. Drafti final i raportit është prezantuar në konferencën për procesin e Referencimit së Kornizës Kombëtare të Kualikimeve në Kornizën Evropiane të Kualikimeve.

Në këtë konferencë kanë marrë pjesë Ministri i MASHT-it Arsim Bajrami, Ministri i MPMS-së Arban Abrashi, Kryetari i Odes Ekonomike, Zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, Fondacioni Evropian për Trajnim – Carmo Gomes si dhe të gjitha palët e interesit në vend, por edhe, përfaqësuesit nga institucionet homologe nga Shqipëria dhe Maqedonia.



Raporti është hartuar në përputhje me metodologjinë dhe kriteret rigoroze të KEK-së, dhe është rezultat i një procesi të gjatë konsultativ me të gjitha palët e interesit, përfshirë edhe ekspertët ndërkombëtar, me këtë rast pasqyron në mënyrë transparente dhe reale sistemin tonë të arsimit dhe trajnimit në të gjitha nivelet duke përfshirë të arriturat, sfidat dhe veprimet e planifikuara për t'i tejkaluar këto sfida, duke mundësuar në këtë mënyrë krahasimin në mes KKK-së me KEK-un. Pas konferencës në nivel vendi, raporti u është dërguar të gjitha shteteve anëtare të BE-së për komente, dhe është prezantuar më 8 Dhjetor në Bruksel nga znj. Teuta Danuza – koordinatore për Kornizën Evropiane të Kualifikimeve në Kosovë me këtë rast edhe është aprovuar dhe referencuar KKK-ja me KEK-un. Referencimi është një e arritur e jashtëzakonshme e Kosovës, sepse do të thotë që sistemi ynë i arsimit dhe trajnimit është transparent, i qartë dhe i besueshëm për shtetet anëtare të BE-së, me këtë rast kualifikimet apo diplomat dhe certifikatat e programeve të studimeve dhe trajnimeve janë të krahasueshme përmes KEK-ut me kualifikimet e vendeve të BE-së duke lehtësuar kështu njohjen dhe qasjen e të rinjve tanë me diploma dhe kualifikime të Republikës së Kosovës në tregun Evropian të punës.

Kosova duhet pas një viti të raportojë për progresin në implementim të KKK-së para grupit këshilldhënës të KEK-ut në të kundërtën tërhiqet referencimi.

Pamje nga Takimi i Grupit Këshillues i Kornizes Evropiane të Kualifikimeve, prezantimi i Raportit të Referencimit të Kornizes Kombetare të Kualifikimeve



AKK në përputhje me objektivat për vitin 2016 ka filluar rishikimin e KKK-së bazuar në kërkesat dhe nevojat pas 5 viteve implementim, duke organizuar punëtori me të gjitha palët e interesit. Kjo punëtori shtjelloi zhvillimet dhe reflektimet e gjendjes aktuale të sistemit të kualifikimeve në Kosovë, ndryshimet e mundshme dhe përshtatjen më praktike të dokumentit me qëllim të jetë brenda kornizave ligjore, të jetë reflektim aktual i sistemit dhe sa më i kuptueshëm për të gjitha palët. Tri grupet punuese të cilat u caktuan për t'i shtjelluar pjesët relevante të dokumentit të KKK-së u ndanë respektivisht në tri kategori: kualifikime, standarde të profesionit dhe sigurim të cilësisë. Secili grup punues përbëhej nga palë të ndryshme të interesit, si shembull në çdo grup një përfaqësues nga institucionet me interes në kuadër të sistemit të kualifkimeve (MASHT, MPMS,MSH), drejtorë të shkollave/ qendrave nga AAP, koordinatorë për SC, mësimdhënës, trajnerë, përfaqësues nga partnerët social siç është Oda Ekonomike, përfaqësues nga projektet, ekspertë të fushave, etj. Puna u fokusua në të gjithë dokumentin duke e analizuar dhe ndërhyrë në secilin paragraf të nevojshëm dhe të vlerësuar nga pjesëmarrësit. Si përfundim kjo punëtori përfundoi fazën e parë të punës në ndërhyrjen në dokumentin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve i cili është publikuar në vitin 2011 dhe tani ka nevojë për t'u rishikuar dhe rifreskuar me informatat rreth proceseve që janë zhvilluar gjatë viteve të fundit.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, gjatë vitit 2016, ka zhvilluar dokumentin politik për dizajnimin e kualifikimeve të AAP-së. Për këtë proces është angazhuar Zt. Hart me ndihmën e Këshillit Britanik. Për këtë proces janë organizuar 3 punëtori me të gjitha palët e interesit të KKK-së dhe AAP-së. Në punëtori janë shtjelluar zhvillimet dhe reflektimet e gjendjes aktuale të sistemit të kualifikimeve në Kosovë, veçanërisht sektorit të AAP-së, propozimet e mundshme dhe praktikat më të përshtatshme për hartimin e kualifikimeve profesionale.

Si rezultat i këtij procesi është zhvilluar një dokument politik që përfshin: arsyeshmërinë dhe bazën e rregullave të kombinimit për kualifikimet formale dhe joformale të AAP-së,



Pamje nga punëtoria për Njohjen e Mësimit Paraprak me Përkrahje të ETF



Pamje nga Punetoria rreth kualifikimeve me përkrahje nga Këshilli Britanik

- ekuilibrimi i moduleve teorike dhe praktike në kualifikimet formale dhe joformale të AAP-së në KKK;
- arsyeshmërinë dhe bazën për modulet obligative dhe opsionale në kualifikimet formale dhe joformale të AAP-së; dhe
- arsyeshmërinë dhe bazën për titujt e kualifikimeve në AAP.

Ky dokument do të lehtësojë procesin e dizajnimit të kualifikimeve për zhvilluesit e kualifikimeve në Kosovë.



Validimii kualifikimeve në KKK dhe akreditimi i ofruesve të AAP

Poshtu, AKK gjatë këtij viti ka vazhduar me popullimin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) duke validuar dhe aprovuar 6 kualifikime të reja në KKK, si dhe akreditуar për herë të parë 13 ofrues për akreditimin e këtyre kualifikimeve, ndërsa ka bërë rishikimin e kushteve të 13 ofrues të akreditуar me kusht. Në total deri tani janë janë aprovuar 27 kualifikime në nivelet kualifikimeve të para në nivelet 2,3,4 dhe 5 në KKK, si dhe janë akreditуar 36 ofrues të cilët ofrojnë, lëshojnë dhe certifikojnë kualifikimeve profesionale. Për këto procese u angazhuan dhe u koordinuan nga AKK-ja 51 panele të ekspertëve me 104 ekspertë të jashtëm.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, ka planifikuar, organizuar dhe ka marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me validimin dhe akreditimin e ofruesve të AAP-së, përfshirë edhe vizitat e paneleve të ekspertëve në teren. Për këtë proces janë angazhuar edhe ekspertë të jashtëm të fushave përkatëse.

Në fillim të procesit për secilin raund është mbajtur një takim me të gjithë ekspertët e paneleve. Këto takime kishin karakter informues në lidhje me procesin e validimit dhe akreditimit të institucioneve aplikuese.

Procedurat dhe vijueshmëria e punës lidhur me të gjitha grupet e panelit ishte si në vijim:

- Takimi për shqyrtimin e aplikacioneve;
- Vizita në teren;
- Përpilimi i raportit final të vlerësimit për validim të kualifikimit dhe akreditim të ofruesve
- Takim për shqyrtimin e aplikacioneve

Pas takimit të parë informues rreth procedurave të validimit dhe akreditimit, zakonisht janë mbajtur edhe takimet e paneleve për shqyrtimin e materialeve dhe dokumenteve të institucioneve aplikuese.







Vizita në teren

Gjatë vizitave në teren panelet u pritën nga menaxherët e institucioneve, zyrtarët për sigurim të cilësisë dhe mësimdhënësit /trajnerët e profileve përkatëse, nxënësit ose pjesëmarrësit e trajnimeve, ndërsa janë vizituar disa punëtori dhe institucione, në të cilat këta kandidatë janë duke e kryer pjesën praktike.

Fillimisht gjatë vizitës u zbatua verifikimi i gjendjes, dëshmive dhe materialeve sipas aplikacionit për validim të kualifikimeve. Sipas procedurave për validimin e kualifikimit u verifikuan këto pika:

- Modulet;
- Struktura e kualifikimit;
- Numri i kredive;
- Qëllimi dhe përmbajta e kualifikimit/ modulit;
- Niveli i kualifikimit/modulit në KKK;
- Pjesa teorike dhe praktike;
- Standardet profesionale;
- Njohja e mësimit paraprak;
- Mënyra dhe kriteret e vlerësimit;
- Literatura.

Poashtu gjatë vizitës edhe sipas aplikacionit për akreditimin e ofruesve, u bë verifikimi i gjendjes, dëshmive, infrastrukturës dhe materialeve, duke përfshirë këto pika:

- Pajisjet dhe mjetet për praktikë;
- Kabinetet dhe punëtoritë;
- Gjendjen financiare;
- Stafin dhe menaxhmentin;
- Kriteret dhe politikat për vlerësimin e kandidatëve me nevoja të veçanta;
- Qasjen e barabartë për kandidatë;
- Sigurinë dhe shëndetin;
- Certifikimin;
- Bazën e të dhënave.

Gjatë këtij procesi u vlerësua përshtatshmëria e objektit me kualifikimin e ofruar, infrastruktura për kandidatë me nevoja të veçanta, siguria dhe çështje tjera me interes.

Përpilimi i raportit final të vlerësimit për validim dhe akreditim

Në kuadër të këtij procesi, panelet përkatëse përpiluan draft raportet për validimin dhe akreditimin për kualifikimet përkatëse të institucioneve aplikuese. Raportet u krijuan duke u bazuar në dokumentet, materialet dhe dëshmitë e ofruara, përfshirë edhe vizitat në institucione, si dhe dëshmitë shtesë dhe informatat kthyese nga institucionet përkatëse. Raportet janë pasqyrim i gjendjes së ofruesit dhe vlerësimi i panelit u bazua konform kritereve të Udhëzimit Administrativ të nxjerrë nga Ligji për Kualifikime Kombëtare. Të gjitha draft raportet janë kthyer në institucione për ta bërë vlerësimin/ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar sipas procedurave të UA-së.

Pas kësaj procedure raportet finale i janë dërguar Këshillit Drejtues të AKK-së me rekomandime për aprovim apo mos aprovim.



Duhet theksuar se i tërë ky proces gjatë vitit 2016, pa marrë parasysh vështirësitë dhe numrin e kufizuar të stafit që ka AKK-ja, ka rrjedhur jashtëzakonisht mirë dhe në frymën e një bashkëpunimi shumë të ngushtë me institucionet aplikuese dhe palët me interes të përfshira në proces.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, nga proceset e lartpërmendura ka rezultuar me validimin dhe regjistrimin e këtyre kualifikimeve në KKK:

- Parukier;
- Pedikyrist;
- Administrimi i rrjeteve dhe sistemeve; dhe
- Zhvillues i aplikacioneve;
- Auditor i certifikuar;
- Kontabilist i certifikuar;
- Auditor i brendshëm;

Gjatë vitit 2016 u akreditуan këto Institucione:

IKAF
• Teknik i kontabilitetit, niveli i KKK;
• Kontabilist i certifikuar, niveli i KKK;
• Auditor i certifikuar, niveli i i KKK;
• Auditor i brendshëm në sektorin privat dhe publik.

UBT
• Administrimi i rrjeteve dhe sistemeve;
• Asistent Administrativ;
• Gjuhë angleze;
• Zhvillues i aplikacioneve; dhe
• Teknologji Informative dhe të Komunkimit.

CAMELLIAS
• Parukier/e;
• Pedikyrist/e.

"KAS" Hair and Beauty School
• Parukier/e.

Ministria e Financave
• Auditor i brendshëm i certifikuar.

SCAAK
• Asistent i auditorit të sektorit publik;
• Teknik i kontabilitetit;
• Kontabilist i certifikuar;
• Auditor i certifikuar;
• Auditor i sektorit publik i sektorit publik;
• Auditor i certifikuar i sektorit publik.

Qendra trajnuese KEK
• Instalues Elektrik;

Oxford Studio
• Gjuhë Angleze.

ELC
• Gjuhë Angleze.

Diakonie Training Centre DTC – Mitrovicë
• Instalues i ujit;
• Instalues i ngrohjes;
• Instalues elektrik.

A.S. Consulting Sr
• Furrtar.

New age
• Gjuhë Angleze.

American Beauty
• Parukier.

Gjatë vitit 2016 u rishikuan edhe institucionet e akredituara me kushte, si në vijim:

QRAP Gjakovë,
• Asistent Administrativ; dhe
• Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

QRAP Pejë,
• Instalues elektrik;
• Instalues i ujit dhe kanalizimit.

QRAP Mitrovicë,
• Saldim dhe
• TIK.

QRAP Prizren
• Saldim;
• TIK.

Britannica,
• Gjuhë Angleze.

London Eye,
• Gjuhë Angleze.

Gjon Nikollë Kazazi,
• Asistent Administrativ.

IADK,
• Teknik i blegtorisë.

QRAP Gjakovë,
• Asistent Administrativ;
• Saldim; dhe
• Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla.

Kolegji UBT
• Asistent Administrativ;
• Administrimi i rrjeteve dhe sistemeve;
• TIK;
• Gjuhë Angleze.

QRAP Gjilan,
• TIK; dhe
• Saldim.

Qatar Charity INFINITY
• Gjuhë Angleze.

KAS
• Parukier.



Pamje nga ambientet e AAP-së

Promovimi i KKK-së dhe AKK-së

AKK-ja ka zhvilluar dhe zbatuar një strategji të vazhdueshme të komunikimit për të mbajtur të informuar mirë të gjitha palët e interesit, duke përfshirë këtu edhe publikun e gjerë. Kjo është bërë nëpërmjet aktiviteteve dhe mjeteve të ndryshme, si në vijim:

- Mbajtja e takimeve me palët e interesit (ofruesve publik, ata privat dhe të të gjithë ofruesve tjerë të AAP-së) në baza të rregullta kohore;
- Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK-në / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik dhe atij privat;
- Organizimin e ceremonisë për shpërndarjen e certifikatave për institucionet ofruese nga procesi i validimit dhe akreditimit;
- Pjesëmarrje në konferenca lokale, regjionale dhe vizita studimore;
- Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara;
- Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar;
- Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes;
- Publikimi dhe shpërndarja e publikimeve të ndryshme, etj.

Organizimi i konferencave, punëtorive informuese për KKK-n / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik / privat

Gjatë vitit 2016 u mbajtën një mori konferencash, punëtori informuese për KKK-në / seminare për grupe të ndryshme të caktuara brenda sektorit publik dhe privat.

AKK gjatë vitit 2016 ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të shkollave publike dhe ofrueseve të akreditуar për implementimin e mekanizmave për sigurim të cilësisë duke organizuar gjithsej dhjetë (10) në rajonin e Prishtinës, Ferizajit, Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit. Në këto punëtori kanë marrë pjesë zyrtarët e MASHT-it për AAP-në, drejtorët, koordinatorët për sigurim të cilësisë dhe inspektorët rajonal në secilin regjion. Në këtë punëtori janë trajtuar çështjet si në vijim: Vetëvlerësimi sipas KKSC-së në Sistemin e Arsimit dhe Aftësimit profesional, Vlerësimi dhe informata kthyese, Plani i veprimit, Plani i përmirësimit/Plani zhvillimor, Planifikimi i buxhetit, Planifikimi i projekteve për AAP-n etj.




Punetori per Rishikimin e KKK - Sektori i Kualifikimeve

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, gjatë vitit 2016, ka organizuar trajnimin e trajnerëve – zhvillimi i kompetencës së pjesëmarrësve në validimin e mësimit joformal dhe informal NJMP. Deri më tani AKK-ja ka zhvilluar Udhëzimin Administrativ rreth NJMP-së me numër 31/2014, së bashku me Agjencinë Kosovare të Akreditimit dhe poashtu ka zhvilluar dokumentin e politikave dhe procedurave të NJMP-së, duke specifikuar detajet e procesit dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira në këtë dokument. Si rezultat i këtij dokumenti është edhe përgjegjësia e AKK-së rreth trajnimeve të palëve të interesit për zbatimin e NJMP-së, më konkretisht trajnime për koordinatorët dhe vlerësuesit e NJMP-së. Ky aktivitet u organizua me përkrahjen e Fondacionit Evropian të Trajnimeve me ekspertizë ndërkombëtare në trajnimin 4 ditor. Synimi i këtij trajnimi ishte fuqizimi i ekspertizës së palëve të interesit, të cilët janë ose do të jenë të përfshirë në procedurat e validimit në sistemin e AAP-së në Kosovë si dhe të kontribuojë në qëndrueshmërinë e procesit të NJMP-së. Pjesëmarrës të këtij trajnimi ishin përfaqësues të Ministrisë së Edukimit nga sektori i AAP-së, shkollave të AAP-së, Qendrave të trajnimit dhe ekspertë të fushave të AAP-së.



Punetori per Rishikimin e KKK - Sektori i Sigurimit të Cilesisë



Botimi i materialeve promovuese për audiencën e përgjithshme dhe audiencë të synuar.

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve ka qenë shumë i angazhuar në gjysmën e parë të vitit 2016 në dizajnimin, publikimin dhe shpërndarjen e një sasie të konsiderueshme të dokumenteve të prodhuara nga AKK-ja. Dokumentet kryesore janë publikuar në formë të shtypur, me dizajn dhe shenjë adekuate, në tri gjuhët: shqipe, angleze dhe serbe, dhe u janë shpërndarë institucioneve të ndryshme të AAP-së dhe institucioneve tjera që ofrojnë Trajnime, Arsim dhe Aftësim, si dhe palëve me interes në këtë fushë, përfshirë edhe institucionet partnere jashtë vendit.

Këto publikime janë grupuar si më poshtë:

1. Fletushka informative për AKK-në dhe KKK-në.
2. Raportet vjetore të 2016-tës në të tri gjuhët.

AKK-ja, po ashtu ka publikuar një fletushkë informative që përmban informata mbi rolin e saj në raport me KKK-në, kualifikimet e aprovuara në të, ofruesit e AAP-së të akreditуar nga AKK-ja, si dhe përfitimet e individit, partnerëve social dhe ofrueseve të AAP-së nga zbatimi i KKK-së. Fletushka është shpërndarë në një numër të madh të ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme me palët e interesit.

Pjesëmarrja në media elektronike dhe të shkruara

Për të gjeneruar vetëdijesimin e publikut në përgjithësi, është zhvilluar një fushatë me pjesëmarrjen e menaxhmentit në programe televizive.
Drejtoresha e AKK-së ka marrë pjesë në një numër të programeve televizive dhe të radios, në të cilat është diskutuar roli i AKK-së, funksioni dhe objektivat e KKK-së, mekanizmat e zhvilluara nga KKK-ja për zbatimin e saj, si dhe përfitimet e individit nga zbatimi i KKK-së.

Artikuj të ndryshëm mbi aktivitet e AKK-së u publikuan në këto mediume: Kosova Sot, Lajm, dhe Epoka e re.





Zhvillimi dhe rishikimi i ueb-faqes

Zhvillimi dhe lansimi i ueb-faqes së AKK-së është bërë në tri gjuhë. Ueb faqja përmban informata themelore për AKK-në dhe KKK-në, dokumente dhe publikime, të cilat janë aprovuar nga KD i AKK-së.

Ueb-faqja, gjithashtu përmban materialet e publikuara, në mënyrë që të mund t'iu ofrohen të gjitha palëve të interesuara, dokumentet në format elektronik. Gjithashtu, në këtë ueb-faqe është publikuar edhe lista për institucionet e akredituara. Megjithatë, ueb-faqja është përmirësuar për të sistemuar një sasi më të madhe të informatave dhe për të ofruar mundësi më të mirë kërkimi, si dhe ndërlidhje shtesë me ueb-faqet përkatëse. Në ueb faqe janë vendosur edhe video dhe audio incizimet që janë përdorur në fushatën e mediave për të siguruar qëndrueshmëri të vazhdueshme të mesazheve të promovuara.



Pamje nga vizita studimore rreth NjMP - Paris Francë

Bashkëpunimi ndërkombëtar AKK-ja edhe gjatë vitit 2016 ka vazhduar me bashkëpunimin ndërkombëtar duke marrë pjesë në takimet e EQAVET-it (rrjetit Evropian për Sigurim të Cilësisë) në takimet e KEK-ut (Kornizës Evropiane të Kualifikimeve) si dhe nëpër rrjetet e ndryshme rajonale.

AKK-ja, gjithashtu ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara nga ERI SEE-ja dhe ECVET-i.

Në shkurt të vitit 2016 AKK-ja me ftesë të ETF-i ka marrë pjesë në Konferencën me titull "Modernizimi i sigurimit të cilësisë në AAP" të mbajtur në Torino. Qëllimi kryesor ishte diskutimi me të gjithë akterët relevantë dhe ekspertët e fushës në nivel të Ballkanit Perëndimor, instrumentet ekzistuese për të mbështetur sigurimin e cilësisë në AAP siç është Korniza Evropiane për Sigurim të Cilësisë në AAP (EQAVET). Pjesëmarrës ishin rreth 50 vetë, të cilët përfaqësonin institucionet përgjegjëse rreth implementimit të Kornizës Evropiane të Sigurimit të Cilësisë në AAP, të shteteve të ndryshme të Ballkanit Perëndimor (BP) si dhe Evropës, përfaqësues të Komisionit Evropian, CEDEFOP, ETF, etj. AKK-ja në mars të vitit 2016, mori pjesë në vizitën studimore në Paris/Francë, të organizuar nga ETF së bashku me AKK-në. Qëllimi i kësaj vizite ishte që të merren njohuri dhe të shihen eksperiencat e Francës sa i përket implementimit të Njohjes së Mësimit Paraprak si dhe përgatitja e trajnerëve që do të trajnojnë në të ardhmen vlerësuesit e njohjes së mësimit paraprak. Gjatë kësaj vizite u mbajtën disa takime të ndryshme si në Ministrinë e Punës së Francës, Ministrinë e Arsimit të Francës, në DAVA institucion publik në kuadër të Ministrisë së Arsimit që bën njohjen e mësimit paraprak, në universitet dhe në disa institucione tjera. Qëllimi i kësaj vizite studimore ishte përfitimi i njohurive rreth implementimit të Njohjes së Mësimit Paraprak duke u bazuar në praktikat më të mira të cilat i kanë përdorur edhe institucionet franceze, për të cilën njihet si vendi më i miri ku aplikohet NJMP-ja.

Poashtu, në mars u mbajt vizita studimore në Ankara të Turqisë rreth Njohjes së Mësimit Paraprak. Qëllimi i kësaj vizite ishte për të shkëmbyer informacione dhe praktikat më të mira për vlerësimin e mësimit formal dhe joformal dhe të përgatisë rekomandime për vendet se si të vazhdojë të zhvillojë dhe zbatojë sistemet e tyre kombëtare për vlerësimin e mësimit joformal dhe informal.

AKK-ja, në prill të vitit 2016 ka marrë pjesë edhe në konferencën në Hagë, konferencë e organizuar nga Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK), anëtare e të cilës është edhe Kosova që nga viti 2015. Konferenca kishte në fokus shkëmbimin e përvojave të zhvilluara në nivel lokal, kombëtar dhe Evropian për të bërë aftësitë dhe kompetencat e refugjatëve të dukshme. Poashtu, janë trajtuar çështjet lidhur me njohjen e mësimit paraprak dhe se si kjo mund të implementohet në shtete të ndryshme.

Gjithashtu, AKK-ja në po të njëjtin muaj, mori pjesë në seminarin për sigurimin e cilësisë në AAP në kontekstin e kualifikimeve, i cili u mbajt në Poloni. Qëllimi i këtij seminari ishte diskutimi dhe shkëmbimi i përvojave me të gjithë akterët relevantë ndërkombëtar dhe ekspertët e fushës në nivel evropian, instrumentet ekzistuese për sigurimin e cilësisë në sistemin formal dhe joformal të AAP-së me theks të veçantë në cilësinë e certifikimit të kualifikimeve. Në mënyrë specifike për t`u ndihmuar ofruesve të AAP-së në zbatimin e strategjive të sigurimit të cilësisë sipas parimeve EQAVET-it; për të mbështetur anëtarët e rrjetit në zhvillimin e ekspertizës së tyre në mënyrë që të promovojnë mobilitetin e fuqisë punëtore dhe për të zhvilluar kapacitetet e ofruesve të AAP-së dhe anëtarëve të rrjetit për të informuar dhe trajnuar stafin e tyre, të sigurojë ndihmë për palët e interesuar të lëvizin drejt implementimit të EQAVET.

Në maj të vitit 2016, AKK-ja mori pjesë në Konferencën dy ditore "Krijimi i aleancës së Ballkanit Perëndimor për të nxënit në punë", e mbajtur në Vienë të Austrisë. Synimi i kësaj konference ishte që të promovojë mësimin dual në AAP në vendet e Ballkanit Perëndimor duke prezentuar benefitet e pilotprojekteve të implementuara në vende të ndryshme të Evropës dhe Ballkanit Perëndimor.



Poashtu gjatë konferencës janë diskutuar edhe sfidat e implementimit të mësimit dual siç jane: mungesa e vetëdijes së parnerëve social lidhur me rolin e tyre në AAP-së, implikimet financiare me rastin e implementimit të mësimit dual (pagesa e sigurimit shëndetësor, trajnimi i inspektorëve në kompani) si dhe përgjegjësia e palëve të interesit etj.

AKK mori pjesë në takimin e 36-t të KEK-ut që u mbajt në Bruksel në muajin qershor. U diskutua per implikimet e agjendës së re të shkathtësive që u miratua më 10 qershor nga ana e Komisionit. Dokumenti përmbante 10 veprime rreth tre prioriteteve: 1. Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësia e formimit të shkathtësive; 2. Duke i bërë aftësitë dhe kualifikimet më të dukshme dhe të krahasueshme; dhe 3. Përmirësimi i aftësive dhe intelegjencës, informacion për zgjedhje më të mira të karrierës. Komisioni paraqiti propozimin për rishikimin e rekomandimit të KEK-ut, e cila është një nga 10 veprimet. Pas diskutimeve anëtarët u dakorduan që komisioni do të paraqesë propozimin për një Rekomandim për Garancinë e Shkathtësive në takimin e KEK-ut në tetor si dhe komisioni do të paraqesë propozimin për rishikimin e vendimit Europass të miratuar.

Në qershor të vitit 2016, AKK-ja mori pjesë në seminarin njëditor të mbajtur në Bruksel nga Komisioni Evropian me rastin e lëshimit të agjendës së re të shkathtësive për Evropë. Në këtë seminar u diskutua për Komisionin Evropian i cili kishte nisur agjendën e aftësive të reja për të rritur kapitalin njerëzor, punësimin dhe konkurrencën në Evropë si dhe për të adresuar sfidat e sotme dhe të përgatitet për të ardhmen. Veprimet fokusoheshin në sigurimin e shkathtësive më të larta dhe më të rëndësishme për njerëzit, përmirësimin e transparencës së shkathtësive, përdorimin e tyre dhe të kuptuarit më të mirë të nevojave të aftësive dhe trendeve në tregun e punës.



Pamje nga pjesëmarrja e perfaqesuesve të AKK-së në Konferencën Evropiane për Sigurim të Cilësisë në AAP. "Praktikat dhe mësimet e mësuara prej implementimit të suksesshëm në nivelin kombëtar të Sigurimit Evropian të Cilësisë për Arsim dhe Aftësim Profesional EQAVET" në Holandë.

Poashtu gjatë konferencës janë diskutuar edhe sfidat e implementimit të mësimit dual siç janë: mungesa e vetëdijes së parnerëve social lidhur me rolin e tyre në AAP, implikimet financiare me rastin e implementimit të mësimit dual (pagesa e sigurimit shëndetësor, trajnimi i inspektorëve në kompani) si dhe përgjegjësia e palëve të interesit etj.

AKK mori pjesë në takimin e 36 të KEK që u mbajt në Bruksel në muajin qershor. U diskutua per implikimet e agjendës së re të shkathtësive që u miratua më 10 qershor nga ana e Komisionit. Dokumenti përmbante 10 veprime rreth tre prioriteteve: 1. Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësinë e formimit të shkathtësive; 2. Duke i bërë aftësitë dhe kualifikimet më të dukshme dhe të krahasueshme; dhe 3. Përmirësimi i aftësive dhe intelegjencës, informacion për zgjedhje më të mira të karrierës. Komisioni paraqiti propozimin për rishikimin e rekomandimit KEK, e cila është një nga 10 veprimet. Pas diskutimeve anëtarët u dakorduan që komisioni do të paraqesë propozimin për një Rekomandim për Garancinë e Shkathtësive në takimin e KEK-ut në tetor si dhe komisioni do të paraqesë propozimin për rishikimin e vendimit Europass të miratuar.

Në qershor të vitit 2016, AKK-ja mori pjesë në seminarin njëditor të mbajtur në Bruksel nga Komisioni Evropian me rastin e lëshimit të agjendës së re të shkathtësive për Evropë. Në këtë seminar u diskutua për Komisionin Evropian i cili kishte nisur agjendën e aftësive të reja për të rritur kapitalin njerëzor, punësimin dhe konkurrencën në Evropë si dhe për të adresuar sfidat e sotme dhe të përgatitet për të ardhmen. Veprimet fokusoheshin në sigurimin e shkathtësive më të larta dhe më të rëndësishme për njerëzit, përmirësimin e transparencës së shkathtësive, përdorimin e tyre dhe të kuptuarit më të mirë të nevojave të aftësive dhe trendeve në tregun e punës.

Poashtu, në qershor AKK-ja mori pjesë në Konferencën Evropiane për Sigurim të Cilësisë në AAP "Praktikat dhe mësimet e mësuara prej implementimit të suksesshëm në nivelin kombëtar të Sigurimit Evropian të Cilësisë për Arsim dhe Aftësim Profesional EQAVET" të mbajtur në Holandë. Çështjet e diskutuara ishin të rejat në kontekstin e politikëbërjes në EQAVET sipas raportit kombëtar të referimit, ku të gjitha vendet anëtare pjesëmarrëse prezantuan të arriturat, të rejat relevante dhe sfidat për sigurimin e cilësisë.

Në tetor të vitit 2016, AKK mori pjesë në konferencën dy ditore me ftesë nga Ballkan Sun Flowers nga Kosova dhe e organizuar nga organizata Pomoc Deci dhe rrjeti PREDECE në Beograd me temën "What are young children telling us". Çështjet e diskutuara kishin të bëjnë me zhvillimin e fëmijërisë së hershme, vetëdijësimi i fëmijëve dhe edukimi i tyre ndaj dallimeve etnike, mbështetja e jetesës së të rinjve në regjionet të dala nga konfliktet dhe sfidat që dalin nga zhvillimi i fëmijërisë së hershme për këtë kategori të fëmijëve etj.


AKK-ja në tetor të këtij viti, mori pjesë poashtu në ngjarjen e mbajtur nga EQAVET – rrjeti Evropian për Sigurim të Cilësisë në AAP lidhur me indikatorin e 5-të të Ciklit të sigurimit të cilësisë. Objektivat e kësaj ngjarje ishin që të shkëmbehen informata lidhur me të dhënat kualitative të kandidatëve/studentëve pas përfundimit të studimeve/trajnimeve në treg të punës. U prezentuan sisteme të ndryshme të përcjelljes së kandidatëve/studentëve nga shtete të ndryshme si Vales, Danimarka, Republika Ceke dhe çështjet



Pamje nga vizita studimore në Beograd

që u diskutuan ishin: punësimi i nxënësve/ kandidatëve të AAP-së pas studimeve/ trajnimeve, çështje metodologjike dhe operacionale si dhe çështja e shfrytëzimit dhe interperetimit të të dhënave.

Në tetor të vitit 2016, AKK mori pjesë në vizitën studimore të financuar nga projekti KEEN që u mbajt në Lublanë të Sllovenisë, me qëllim të shkëmbimit e të mësimit të praktikave më të mira të Sllovenisë në fushën e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes, me theks të veçantë në pjesëmarrjen e OJQ-ve në bërjen e politikave. Në këtë vizitë u dha mundësia për të mësuarit më tepër rreth këtyre praktikave, rreth mënyrës së organizimit dhe qasjeve të ndryshme nga institucionet qeveritare, nga institucionet arsimore, nga OJQ-të dhe nga sektori privat. Qëllimi i vizitës studimore ishte për të mësuar nga praktikat e mira në Lubjanë në fushën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, me theks të veçantë në pjesëmarrjen e OJQ-ve në hartimin e politikave.



Pamje nga pjesëmarrja e përfaqësuesve të
AKK-së në vizitën studimore në Lublanë, Slloveni

AKK-ja mori pjesë në takimin e 37-të KEK-ut që u mbajt në Bruksel në muajin tetor. U diskutua për implikimet e agjendës së re të shkathtësive në KEK dhe atë në fushën e sigurimit të cilësisë, kredive, kualifikimeve ndërkombëtare, dimensionit të vendeve të treta si dhe qeverisjes së KEK-ut. Gjithashtu, janë diskutuar zhvillimet e fundit në nivel shtetëror lidhur me KEK meqë rast është konfirmuar që Kosova do të prezantojë raportin e referencimit në Bruksel në dhjetor të këtij viti.